

Titulli i lëndës: Morfologji e gjuhës gjermane

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Morfologji e gjuhës gjermane
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	i obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i II-të Semestri i IV-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. asoc. dr. Teuta Abrashi
Të dhënat kontaktuese:	teuta.abrashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Morfologjia (greqisht μορφή, morphé ", formë, formën," dhe λόγος, logos, "fjalë, doktrina, arsyeja"), në gjuhësi është një nëndegë e gramatikës e gjuhës gjermane. Morfologjia merret me strukturën interne e fjalës dhe i dedikohet hulumtimit e elementeve me kuptim dhe funksion me te vogël e gjuhës, pra morfemat. Prandaj morfologjia mund te quhet edhe "gramatika e fjalës". Gjithashtu morfologjia merret me format e lakimit dhe fjalëformimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është njohja e studentëve me bazat e morfologjisë së gjuhës gjermane. Ata do njihen me kriteret ortografikë, distribucionalë, fonologjikë dhe semantikë të definicionit të fjalës, me proceset e fjalëformimit dhe klasifikimit të tyre në gjuhë e sotme gjermane si dhe me konceptin dhe problematikën e llojeve të morfemave. Do të shtjellohen detajisht strukturat flektive të gjuhës gjermane bashkë me sistemin e saj ndajshesor. Pjesët e ligjëratës dhe tipat e ndryshëm morfologjikë të fjalëve, bashkë me nënkategorizimin e tyre, do të jenë në qendër të vëmendjes, me theks të veçantë në sistemin emëror dhe

foljor. Gjithnjë, duke i përfshirë të gjitha kategoritë e këtyre strukturave dhe aspektet e tjera të rëndësishme për zotërimin e tyre teorik dhe praktik. Përdorimi dhe zbatimi i teorisë së strukturave morfologjike në praktikë do të jenë qenësore, brenda dhe jashtë një konteksti të caktuar.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje:

- të bëjë analizë morfologjike të fjalëve, segmentimin e tyre në morfema, identifikimin dhe klasifikimin e morfemave
- t'i identifikojë dhe t'i veçojë të gjitha format themelore dhe flektive të gjuhës gjermane bashkë me kuptimet e tyre
- të bëjë analizë në përbërës të drejtpërdrejtë në nivel të fjalës
- t'i kategorizojë fjalët varësisht nga struktura dhe nga mënyra e formimit të tyre
- ta bëjnë kategorizimin e fjalëve sipas llojit të fjalëformimit
- t'i dallojë konceptet themelore të analizës gramatikore në përgjithësi dhe të analizës së fjalës në veçanti

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë nëpërputhje me rezultatete nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	22.5
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			

Testi, punimi i seminarit	8	2	16
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	5	2	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	30 min	1	0.5
Total			148:25 = 5.92 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	<p>Studentët janë të obliguar t'i lexojnë materialet përkatëse para orës. Mësimdhënia dhe mësimnxënia nuk do të shihen të ndara prerash, sipas procedurave rigjide, por do të jenë vazhdimisht të ndërlidhura me njëra tjetrën, si marrje dhe dhënie e ndërsjellë, që i ofrojnë mundësi secilit student të marrë pjesë në këtë proces dhe të japë kontributin personal në prodhimin e vazhdueshëm të dijes.</p> <p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrime (puna praktike) si dhe detyrave të vazhdueshme në shtëpi.</p>
--------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	<p>Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50%.</p> <p>kollokviumi i parë (Zwischenprüfung);</p> <p>kollokviumi final (Endprüfung);</p> <p>Provimi:</p> <p>Për ata që nuk tregojnë sukses në kollokviume, do të mbahet provimi përmbledhës në afatin e provimeve. Provimi është vetëm me shkrim.</p>
------------------------------	--

Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjëratat të përgatitura nga prof.ass.dr.Teuta Abrashi 2. Elsen, H. (2013): <i>Wortschatzanalyse</i>, UTB, Narr/Franke: Tübingen 3. Hoffmann, L. (2013): <i>Deutsche Grammatik</i>, Erich Schmidt Verlag: Berlin 4. Heringer, H.J. (2013): <i>Deutsche Grammatik- ein Arbeitsbuch für Studierende und Lehrende</i>, UTB W. Fink:Paderborn 5. Hoffmann, L. (2009): <i>Handbuch der deutschen Wortarten</i>, de Gruyter Studienbuch: Berlin/ New York. 6. Heringer, H. J. (2009): <i>Morphologie</i>, UTB, W. Fink: Paderborn 7. Römer, C. (2006): <i>Morphologie der deutschen Sprache</i>, UTB, Narr:Francke, Tübingen 8. Donalies, E.(2005): <i>Die Wortbildung des Deutschen</i>, 2. Aufl., Narr:Tübingen.
----------------------------	---

Literatura shitesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Busch,A./Stenschke,O.(2007): Germanistische Linguistik, Tübingen: Narr Franke (S.75-114) 2. Duden- Grammatik (2005)Bd.4 Mannheim 3. Engel U (2004): Deutsche Grammatik, München 4. Meibauer, J. (et.al) (2002): Einführung in die germanistische Linguistik, Stuttgart: Metzler (S.15-67)
----------------------------	---

5. Vater, H. (1996): Einführung in die Sprachwissenschaft, München: Fink (S.68-103)

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Morfologji: Përcaktimi i konceptit Lënda dhe detyrat Morfologjia dhe disiplinat të tjera shkencore
Java 2:	Pjesët e ligjëratës definicioni tradicional kriteri semantik, sintaksor dhe morfologjik
Java 3:	Ç'është një fjalë? kriteret ortografike /kriteret fonologjike/ kriteret semantike/ kriteret distribucionale
Java 4:	Struktura e fjalëve fjala gramatikore dhe leksikore tipologjia e morfemave
Java 5:	Kategoritë morfologjike -Identifikimi dhe klasifikimi morfi, morfema, alomorfi përcaktimi i morfemave
Java 6:	Segmentimi prej tekstit deri te "çifti minimal" sinkroni dhe diakroni
Java 7:	kollokviumi i parë (Zwischenprüfung) rezultate
Java 8:	Fleksioni Deklination (Nomen, Adjektive) Konjugation (Verben) Komparation (Adjektive)
Java 9:	Modelet morfologjike deskriptive funktionale gjenerative dependencial
Java 10:	Proceset fjalëformuese proceset kryesore/ periferike
Java 11:	Derivacioni

Java 12:	Kompozicioni
Java 13:	Konversion Amalgierung Abkürzungen (shkurtëza)/ Entlehnungen (huazimet)
Java 14:	Përsëritja e lëndës
Java 15:	kollokviumi përfundimtare (Endprüfung) rezultate

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk tolerohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti i nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së.